



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

<b>Drejtoria</b>	Drejtoria e Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve
<b>Periudha raportuese</b>	Muaji Tetor 2022
<b>Emri dhe mbiemri i raportuesit</b>	Znj. Donika Cetta Drejtoreshë e Drejtorisë së Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve

**1. PËRMBLEDHJE** - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve ka vazhduar përgjatë muajit Tetor, realizimin e detyrave të caktuara në bazë të planit të punës për rekultivimin e hapësirave të gjelbërta si dhe krijimin e hapësirave të reja të gjelbërta dhe parqeve në Komunën e Prishtinës.

**2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA** - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara sipas planprogramit dhe fushës së veprimit të Komunës për drejtorinë e Parqeve:

- Përcjellja – mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana e NPL “Hortikultura”, dhe kujdesi ndaj zonave të gjelbërta brenda territorit të Komunës së Prishtinës; krasitja e drunjëve që paraqesin rrezik nga rrëzimi i tyre;
- Përgaditja dhe inicimi i projekteve për tenderim për krijimin e hapësirave të reja rekreative brenda qytetit të Prishtinës;
- Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirave të parqeve për aktivitete;
- Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e Qendrës Rekreative “Gërmia” për aktivitete sensibilizuese dhe edukuese;
- Pranimi i kërkesave dhe ankesave nga qytetarët, shqyrtimi i tyre edhe nga subjektet tjera komunale dhe dërgimi i tyre për personin apo subjektin që i dedikohen;

### **3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA:**

- Evidentimi i zonave të përshtatshme për krijimin e hapësirave të reja të gjelbërta dhe rekreative në kryeqytet;
- Përcjellja – mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana NPL “Hortikultura”, krasitja e drunjëve dhe prerja e drunjëve që paraqesin rrezik nga rrëzimi i tyre dhe pune të tjera të mirëmbajtjes dhe pastrimit të hapësirave të gjelbërta;
- Krasitja e e degëve të drunjëve të cilat paraqesin probleme pas pranimit të kërkesave nga qytetarët.
- Mbjellja e rreth 260 drunjëve në Rr.Fatime Sokoli
- Mbjellja e 55 drunjëve tek Tregu i vjetër Rr.Ilaz Agushi
- Krijimi i hapësirës gjelbëruese dhe mbjellja e drunjëve në ishullin tek Rr.Zekeria Cana
- Mbjellja e drunjëve dekorativë dhe shkurreve përgjatë sheshit Zahir Pajaziti, Nëna Terezë dhe Sheshi Skënderbe;
- Mbjellja e pishave në Sheshin Nëna Terezë të kultivuara nga vetë Nëna Terezë – nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulurore të Shqiptarëve – Shkup (ITSHKSH);

### **4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR -**

- Përcjellja – mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet dhe mbjelljen e tyre nga ana e NPL “Hortikultura”;
- Përcjellja dhe mbikëqyrja e punimeve në Parkun Linear – Lagjia e Spitalit;
- Identifikimi i hapësirave publike për rigjenerim të tyre përmes projekteve;
- Përmirësimi i infrastrukturës në parqet ekzistuese;

### **5. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim të sipër**

Numri i lëndëve të pranuar: 32

Numri i lëndëve të kryera: 23

Numri i lëndëve të refuzuara: 0

Numri i lëndëve të ceduara: 0

Numri i lëndëve në proces: 9

### **6. Takime të tjera:**

- Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe Youth Are The Real Leaders (YARL);
- Diskutimi Publik me të rinjtë dhe banorët e lagjes Ulpiana rreth implementimit të projekteve “Feramat Urbane” dhe “Këndi i Lodrave për Fëmijë me Karrocë” për fëmijët me nevoja të veçanta;
- Diskutim Publik me banorët e Rr.Rexhep Luci për krijimin e asaj rruge në shesh dhe ndalim qarkullimi për automjete;
- Takim me Kryeshefin e Ujësjetës për planifikimin e ndërtimit të Parkut Botanik në Fushën e Pajtit.

## **7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES –**

- Organizimi dhe kordinimi i planeve operacionale dhe përcjellja – mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen dhe mbjelljen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana NPL “Hortikultura”;
- Inagurimi i fillimit të punimeve në parkun Mati 1- te Banesat e Standardit;
- Inagurimi i fillimit të punimeve në parkun Arbëri dhe Parkun Vertikal tek nën rrethrotullimi për Fushë Kosovë
- Inicimi i procedurave të prokurimit për kontratën për Parkun në Rr.Sylejman Vokshi